



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 259

Tiranë – E premte, 6 janar 2017

## PËRMBAJTJA

|                                      | Faqe   |
|--------------------------------------|--|
| Ligj nr. 122/2016<br>datë 15.12.2016 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar..... 26521  |
| Ligj nr. 123/2016<br>datë 15.12.2016 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”..... 26522  |
| Ligj nr. 124/2016<br>datë 15.12.2016 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar..... 26523   |
| Ligj nr. 125/2016<br>datë 15.12.2016 | Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin “Shqipëria: plani i ristrukturimit të KESH-it”..... 26524 |
| Ligj nr. 129/2016<br>datë 15.12.2016 | Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 26543  |



**LIGJ**  
**Nr. 122/2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË LIGJIN NR. 9880, DATË 25.2.2008,  
“PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK”,  
TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

**Neni 1**

Në nenin 3, pika 15 ndryshohet si më poshtë:

“15. “Autoriteti Përgjegjës për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (Autoriteti)” është organi shtetëror i ngarkuar për mbikëqyrjen e kuadrit rregullator, të përcaktuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.”.

**Neni 2**

Neni 10 riformulohet si më poshtë:

**“Neni 10**

**Autoriteti Përgjegjës për Certifikimin  
Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

1. Autoriteti është autoriteti kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë elektronike, i cili funksionon sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Autoriteti është institucion juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës të fushës.

3. Autoriteti financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

<sup>1</sup>Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 910/2014 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe që shfuqizon Direktivën 1999/93/KE”, Numri CELEX 32014R0910, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 257, datë 28.8.2014, faqe 73-114.

4. Autoriteti përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Marrëdhëniet e punës të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të Autoritetit rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës të punonjësve administrativë rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

6. Autoriteti, në ushtrim të funksioneve të tij, nxjerr udhëzime për të rregulluar veprimtarinë e ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar.

7. Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 3**

Neni 22 riformulohet si më poshtë:

**“Neni 22**

**Transferimi i detyrave të shërbimeve të  
certifikimit**

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit mund t’u transferojë, me marrëveshje, personave të tretë, këto detyra:

a) procesin e identifikimit të zotëruesve të certifikatave;

b) gjenerimin e certifikatave të kualifikuara;

c) dorëzimin e pajisjes përkatëse, ku ruhet certifikata e kualifikuar.

2. Transferimi nuk përjashton përgjegjësinë e ofruesit të shërbimit për detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

3. Procedurat për transferimin e detyrave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, janë pjesë e rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.”.

**Neni 4**

Në nenin 54, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Europian dhe janë të akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.”.



## Neni 5

Neni 59 riformulohet si më poshtë:

“Neni 59  
**Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, 14, 19, 22, 28, 52, 54 e 55 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për miratimin e rregullores së brendshme të Autoritetit.”.

## Neni 6

**Dispozita kalimtare**

1. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe buxheti i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik i transferohen autoritetit përgjegjës, që krijohet me këtë ligj.

2. Për nëpunësit civilë ekzistues të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik zbatohen dispozitat e legjislacionit të nëpunësit civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

3. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik do të vazhdojë të kryejë veprimtarinë e tij deri në momentin e fillimit të funksionimit të autoritetit të ri përgjegjës.

4. Kudo në këtë ligj, emërtimi “Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik” zëvendësohet me emërtimin “Autoriteti Përgjegjës për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.

## Neni 7

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Miraturar në datën 15.12.2016

**Shpallur me dekretin nr.9928, datë 30.12.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ****Nr. 123/2016****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË LIGJIN NR. 107/2015, “PËR  
IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE  
SHËRBIMET E BESUARA”<sup>2</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## KUVENDI

## I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

## Neni 1

Në nenin 7, në fund të pikës 1, hiqet termi “elektronik”.

## Neni 2

Në nenin 27, paragrafi i fundit zëvendësohet me paragrafin me këtë përmbajtje:

“Rregullat për ofrimin e shërbimeve publike elektronike, që përfitojnë nëpërmjet transmetimit elektronik, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

## Neni 3

Në nenin 34, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit European dhe janë të akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.”.

<sup>2</sup>Ky ligj është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 910/2014 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe që shfuqizon Direktivën 1999/93/KE”, Numri CELEX 32014R0910, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.257, datë 28.8.2014, faqe 73-114.



Neni 4

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.12.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9929, datë 30.12.2016 të Presidentit të Republikë së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**

**Nr. 124/2016**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË LIGJIN NR. 10 273, DATË 29.4.2010,  
“PËR DOKUMENTIN ELEKTRONIK”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI****I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. “Vulë elektronike” janë të dhëna në formë elektronike, sipas përkufizimit të ligjit nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.”.

Neni 2

Në nenin 6, shkronja “a” riformulohet si më poshtë:

“a) nënshkrim elektronik dhe/ose vulë elektronike, sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.

Neni 3

Në nenin 7, shkronja “b”, pas fjalëve “nënshkrime elektronike” shtohen fjalët “dhe/ose vula elektronike”.

Neni 4

Në nenin 12, pika 2, pas fjalëve “nënshkrimit elektronik”, shtohen fjalët “dhe/ose vulës elektronike”.

Neni 5

Në nenin 13, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Procedura dhe rregullat për qarkullimin e dokumentit elektronik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Në nenin 18, pika 3, bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën “a”, pas fjalëve “të dhënat e nënshkrimit elektronik” shtohen fjalët “dhe/ose vulës elektronike”.

2. Në shkronjën “b”, pas fjalëve “së bashku me nënshkrimin elektronik” shtohen fjalët “dhe/ose vulën elektronike”.

Neni 7

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.12.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9930, datë 30.12.2016 të Presidentit të Republikë së Shqipërisë, Bujar Nishani**



**LIGJ**  
Nr. 125/2016

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
SË GARANCISË NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
FINANCAVE, DHE BANKËS  
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE  
ZHVILLIM (BERZH), NË LIDHJE ME  
MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET  
KORPORATËS  
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE  
DHE BANKËS EUROPIANE PËR  
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH),  
PËR PROJEKTIN “SHQIPËRIA: PLANI I  
RISTRUKTURIMIT TË KESH-IT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për projektin “Shqipëria: Plani i ristrukturimit të KESH-it”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.12.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9931, datë  
30.12.2016 të Presidentit të Republikë së  
Shqipërisë, Bujar Nishani**

(Numri i veprimit 48132)

**MARRËVESHJE GARANCIE**  
(SHQIPËRI: PLANI I RISTRUKTURIMIT TË  
KESH-IT) NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE  
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Ky draft Marrëveshjeje Garancie është përgatitur vetëm për qëllimet e diskutimeve paraprake. **Mund të shtohen marrëveshje shtesë dhe teksti ekzistues është subjekt i ndryshimit dhe miratimit përfundimtar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

Datë [\_\_\_\_\_]

**MARRËVESHJE GARANCIE**  
MARRËVESHJE E DATËS [\_\_\_\_\_]  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
("GARANTUESI") DHE BANKËS  
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE  
ZHVILLIM ("BANKA").

**HYRJJE**

*Duke pasur parasysh që* Garantuesi dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

*duke pasur parasysh që* në vijim të një marrëveshjeje huaje në datën ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës ("Marrëveshja e Huas", siç përcaktohet në Afatet dhe Kushtet Standarde), një kopje e së cilës i është dhënë Garantuesit, Banka ka rënë dakord që t'i japë Huamarrësit një hua në vlerën deri në 218 milionë EURO, në dy këste, prej 118 milionë EURO (e realizuar) dhe 100 milionë EURO (e parrealizuar), në bazë të afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në Marrëveshjen e Huas, por vetëm me kusht që Garantuesi: i) të sigurojë mbështetjen e nevojshme, duke përfshirë sa i përket planit të reformës bashkëlidhur Marrëveshjes së Huas dhe planit të veprimit për qeverisjen e korporatës që do të miratohet në përputhje me planin e reformës; dhe ii) të garantojë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas, secila sipas parashikimit në këtë Marrëveshje; dhe

*duke pasur parasysh që* Garantuesi, duke marrë në konsideratë se Banka lidh Marrëveshjen e Huas me Huamarrësin, ka pranuar të garantojë këto



detyrime të Huamarrësit dhe të kryejë dhe të marrë masa për kryerjen e detyrave të parashtruara në Planin e Reformës.

tani, rrjedhimisht, palët nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje bien dakord si më poshtë:

Neni 1

### **Afatet dhe kushtet standarde; përkufizimet**

#### **Seksioni 1.01 Përmbajtja e afateve dhe kushteve standarde**

Të gjitha dispozitat e afateve dhe kushteve standarde të Bankës të datës 1 dhjetor 2012 janë përfshirë këtu dhe janë bërë të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt, sikur të ishin parashtruar plotësisht këtu (këto dispozita pasi janë ndryshuar në vijim referohen si “Afatet dhe kushtet standarde”).

#### **Seksioni 1.02 Përkufizimet**

Kudo që janë përdorur në këtë Marrëveshje (duke përfshirë hyrjen), përveç kur përcaktohet ndryshe ose kur konteksti e kërkon ndryshe, afatet e përcaktuara në hyrje kanë kuptimet përkatëse, të cilat u janë dhënë atyre, afatet e përcaktuara në afatet dhe kushtet standarde dhe Marrëveshja e Huas kanë kuptimet përkatëse, të cilat ju janë dhënë atyredhe afati i mëposhtëm ka kuptimin që vijon:

“Përfaqësuesi i Autorizuar i Garantuesit” do të thotë ministri i Financave i Garantuesit.

#### **Seksioni 1.03 Interpretimi**

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një neni ose seksioni të specifikuar, me përjashtim kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni ose seksioni të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

### **Garancia; detyrimet për mbështetjen e projektit**

#### **Seksioni 2.01 Garancia**

Garantuesi, me anë të kësaj Marrëveshjeje, garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si debitor primar dhe jo vetëm si garanci, pagesën e duhur dhe të përpiktë të secilës dhe të të gjitha shumave të detyrimeve sipas Marrëveshjes së Huas, qoftë në maturimin e dhënë, me përshpejtim ose ndryshe dhe përmbushjen e përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, të gjitha siç janë përcaktuar në Marrëveshjen e Huas.

#### **Seksioni 2.02 Njoftimi me shkrim**

Banka bie dakord që të gjitha kërkesat për pagesë të bëra Garantuesit në përputhje me këtë Marrëveshje, do të bëhen me shkrim dhe këto kërkesa për pagesë do të specifikojnë shumën e papaguar sipas Marrëveshjes së Huas që do të paguhet nga Garantuesi, e cila do të jetë në një datë jo më pak se tri ditë pune nga data e njoftimit për kërkesën.

#### **Seksioni 2.03 Detyrimi për mbështetjen e Projektit**

a) Kryerja (në lidhje me vetveten) dhe marrja e masave për kryerjen (në lidhje me Huamarrësin dhe me çdo agjenci ose autoritet përkatës shtetëror apo çdo nënndarje përkatëse të tyre ose çdo subjekt në pronësi dhe i kontrolluar prej tyre ose që vepron për llogari ose përfitim të Garantuesit):

1. Secila nga detyrat e parashtruara në Planin e Reformës në datën përkatëse të përcaktuar në të; dhe

2. Nga data në të cilën CGAP miratohet nga Banka dhe nga Huamarrësi, secila nga detyrat e parashtruara në CGAP në datën përkatëse të përcaktuar në të.

b) Të sigurojë që Huamarrësi është në përputhje me secilin nga detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Huasë;

c) Të ndihmojë, në përputhje me ligjet e Shqipërisë, që rregullimet e nevojshme të tarifës së energjisë elektrike të miratohen për të garantuar që aplikimet e tarifës së Huamarrësit në mënyrën e përcaktuar në Planin e Reformës do të përmbushen në përputhje me metodologjinë e miratuar dhe të parashtruar në Planin e Reformës;

d) Të sigurojë që asnjë veprim, i cili do të parandalonte ose ndërhynte në: i) zbatimin e Projektit; ose ii) përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit në lidhje me Projektin, nuk është marrë ose lejuar të merret qoftë nga Garantuesi ose nga çfarëdo agjencie ose autoriteti përkatës shtetëror apo çdo nënndarje përkatëse të tyre ose çdo subjekt në pronësi dhe i kontrolluar prej tyre ose që vepron për llogari ose përfitim të cilësdo prej tyre;

e) Të sigurojë mbledhjen nga Huamarrësi sipas Planit të Reformës, në bazë të Treguesve të Performancës së KESH-it të parashtruar në Planin e Reformës; dhe



f) Të bashkëpunojë me çdo konsulent të angazhuar sipas emërimeve TC, për të garantuar që mund të përmbushë kriteret e tij sipas kontratës.

#### Seksioni 2.04 Detyrime të tjera

Garantuesi nuk do të vendosë asnjë taksë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për konsulentët e huaj të punësuar nga Banka ose nga Huamarrësi për zbatimin e Projektit dhe të financuar nga shuma e Huas ose çdo fond teknik bashkëpunimi të vënë në dispozicion nga Banka.

Neni 3

#### Të ndryshme

#### Seksioni 3.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 10.01 të afateve dhe kushteve standarde:

Për Garantuesin:

Ministria e Financave

Bul. “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë

Albania (Shqipëri)

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Faks: (355) (4) 2228 494

Për Bankën:

European Bank for Reconstruction and Development

(Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Operation

Administration Department

(Departamentit të Administrimit të Operacioneve)

Faks: +44-20-7338-6100

#### Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

Për qëllimet e seksionit 9.03(b) të afateve dhe kushteve standarde dhe në përputhje me seksionin 6.02 të Marrëveshjes së Huas, opinioni ose opinionet e avokatit do të jepen në emër të Garantuesit nga ministri i Drejtësisë.

Në dëshmi të kësaj palë të kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht,

Faqe | 26526

kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje dhe të dërgohet në Tiranë, Shqipëri në ditën dhe në vitin e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: \_\_\_\_\_

Emri:

Titulli:

BANKA EVROPIANE

PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: \_\_\_\_\_

Emri:

Titulli:

(Numri i veprimit 48132)

#### MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJE

(Shqipëri: Plani i Ristrukturimit të KESH-it)ndërmjet

KORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Ky draft Marrëveshjeje huaje është përgatitur vetëm për qëllimet e diskutimeve paraprake. Mund të shtohen marrëveshje shtesë dhe teksti ekzistues është subjekt i ndryshimit dhe miratimit përfundimtar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Datë [\_\_\_\_\_]

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJEE DATËS [\_\_\_\_\_]

NDËRMJET KORPORATËS

ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (“HUAMARRËSI”) dhe BANKËS

EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (“Banka”)

HYRJE

*Duke pasur parasysh* që Banka është themeluar për të dhënë financime për projekte specifike për të mbështetur kalimin drejt ekonomive të orientuara në tregun e hapur dhe për të nxitur iniciativën private dhe sipërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të angazhuara dhe duke zbatuar parimet e demokracisë



shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

*duke pasur parasysh që* Huamarrësi synon të zbatojë Projektin, siç përshkruhet në skedulin 1, i cili është hartuar për të ndihmuar Huamarrësin në ristrukturimin e bilancit të tij dhe në zbatimin e programit gjithëpërfshirës të hartuar për të përmirësuar menaxhimin dhe efikasitetin operacional të infrastrukturës energjetike në Shqipëri;

*duke pasur parasysh që* Republika e Shqipërisë dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për të financuar pjesë të Projektit;

*duke pasur parasysh që* në përputhje me një marrëveshje garancie, të datuar me datën këtu ndërmjet Republikës së Shqipërisë si Garantues dhe Bankës (“Marrëveshja e Garancisë” siç përcaktohet në afatet dhe kushtet standarde), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

*duke pasur parasysh që* Banka ka organizuar një bashkëpunim teknik (“BT”) për të angazhuar një konsulent të jashtëm për të kryer një inspektim të boshllëqeve të drejtimit të korporatës të Huamarrësi dhe zhvillimin e një plani veprimi për të korigjuar këto boshllëqe (“BT i Qeverisjes së Korporatës”) në përputhje me hapat dhe afatin kohor të vendosur në seksionin e “Qeverisjes së Korporatës dhe Strukturës së Korporatës” të Planit të Reformës;

*duke pasur parasysh që* Banka është në procesin e organizimit të BT-së për të angazhuar një konsulent të jashtëm që të ndihmojë Huamarrësin dhe Garantuesin në rritjen e kapacitetit për menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe aftësinë ripërtëritëse klimatike, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, përdorimin e sigurimit të riskut hidrologjik (BT për Ripërtëritjen Klimatike”) në përputhje me hapat dhe afatin kohor të parashtruar në pjesën H (“Ripërtëritja Klimatike”) të Planit të Reformës; dhe

*duke pasur parasysh që* Banka ka rënë dakord në bazë të, *ndër të tjera*, sa më sipër t’i japë një kredi Huamarrësit në shumën deri 218 milionë EURO në bazë të afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në këtë Marrëveshje.

tani, rrjedhimisht, palët nëpërmjet kësaj bien dakord si vijon:

Neni 1

## Afatet dhe kushtet standarde; përkufizimet

### Seksioni 1.01 Përmbajtja e afateve dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e afateve dhe kushteve standarde të Bankës të datës 1 dhjetor 2012 janë përfshirë këtu dhe janë bërë të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin parashtruar plotësisht këtu, megjithatë janë subjekt i ndryshimeve të mëposhtme (këto dispozita pasi janë ndryshuar, më poshtë të referuara si “Afatet dhe kushtet standarde”):

a) Përkufizimet “Euro”, “EUR” ose “€” në seksionin 2.02 të afateve dhe kushteve standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohen dhe do të lexohen si më poshtë:

““Euro”, “EUR” ose “€” do të thotë monedha e ligjshme e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kanë miratuar një monedhë të vetme në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian në lidhje me bashkimin ekonomik dhe monetar.”

b) Përkufizimet “Praktikë detyruese”, “Praktikë konfliktuese”, “Praktikë korruptive” dhe “Praktikë mashtruese” në seksionin 2.02 të afateve dhe kushteve standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të fshihen në tërësinë e tyre.

c) Përkufizimi “Praktikë e ndaluar” në seksionin 2.02 të afateve dhe kushteve standarde për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet dhe interpretohet si më poshtë:

““Praktikë e ndaluar” do të thotë një praktikë detyruese, praktikë konfliktuese, praktikë korruptive, praktikë mashtruese, keqpërdorim i burimeve të Bankës, praktikë penguese ose vjedhje, ashtu si secili nga këto terma është përkufizuar në Politikën dhe në Procedurat Zbatuese të Bankës të datës 5 nëntor 2015 dhe ashtu si këto terma janë interpretuar më tej në Udhëzimet për Praktikën e Ndaluar për Operacionet e BERZH-it të muajit shkurt 2016.”

d) Përkufizimi “Faqe reference” në seksionin 2.02 të afateve dhe kushteve standarde për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet dhe interpretohet si më poshtë:

““Faqe Reference” do të thotë shfaqja e: i) për huat e shprehura në USD (dollarë amerikanë) ose në £ (Paund Britanik), normat e ofruara të bankave kryesore nga rrjeti ndërbankar i Londrës për





depozitat në Monedhën e Kredisë të përcaktuara si faqja LIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters (ose ndonjë faqe tjetër e tillë që mund të zëvendësojë faqen LIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters, me qëllim shfaqjen e normave të ofruara nga rrjeti ndërbankar i Londrës për depozitat në Monedhën e Kredisë), dhe (ii) për Kreditë e shprehura në euro, normat e ofruara nga rrjeti ndërbankar i Euro-Zonës për depozitat në Monedhën e Kredisë të përcaktuara si faqja EURIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters (ose ndonjë faqe tjetër e tillë që mund të zëvendësojë faqen EURIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters, me qëllim shfaqjen e normave të ofruara nga rrjeti ndërbankar i Euro-zonës për depozitat në Monedhën e Kredisë).”

e) Përkufizimi “Dita e SYNUAR” në seksionin 2.02 të Afateve dhe Kushteve Standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet dhe interpretohet si më poshtë:

““Dita e SYNUAR” do të thotë cilado ditë në të cilën sistemi i Transferts Ekspres Trans-Evropiane të Automatizuar në Kohë Reale për Shlyerje Bruto është i hapur për shlyerjen e pagesave në Euro.”

f) Seksioni 3.04 i Afateve dhe Kushteve Standarde për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet që të përfshijë një Seksion të ri 3.04(e), i cili do të interpretohet si më poshtë:

“e) Nëse një dukuri e specifikuar në 7.06 të Afateve dhe Kushteve Standarde ka ndodhur dhe është në vazhdimësi, Banka mund të zgjedhë që t’i kërkojë Huamarrësit të paguajë interesa për pjesën e Kredisë, nëse ka, që është subjekt i një Norme Fikse Interesi, jo me një Norme Fikse Interesi, por në vend të saj me një Normë të Ndryshueshme Interesi.”

g) Seksioni 3.10(b)(2) i Afateve dhe Kushteve Standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet dhe interpretohet si më poshtë: “çdo pjesë e Kredisë, e cila është subjekt i Normës Fikse të Interesit, është përshpejtuar në përputhje me Seksionin 7.06 ose në të kundërt bëhet detyrim për t’u paguar para maturimit të përcaktuar të saj ose bëhet subjekt i një Norme të Ndryshueshme Interesi në përputhje me Seksionin 3.04(e) të Afateve dhe Kushteve Standarde; ose”.

h) Seksioni 7.01(a)(xv) i Afateve dhe Kushteve Standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet dhe do të interpretohet si më poshtë:

“Banka do të ketë pezulluar ose ndryshe ndryshuar aksesin ndaj burimeve të Bankës nga Anëtari në vijim të vendimit të Bordit të Guvernatorëve të Bankës”.

i) Seksionet 3.05(a) dhe 3.05(b) të Afateve dhe Kushteve Standarde nuk do të zbatohen për këtë Marrëveshje.

### Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që të jenë përdorur në këtë Marrëveshje (duke përfshirë Hyrjen dhe Skedulit), përveçse kur përcaktohet ndryshe ose kur konteksti e kërkon ndryshe, afatet e përcaktuara në Hyrje kanë kuptimet përkatëse të cilat u janë dhënë atyre aty, afatet e përcaktuara në Afatet dhe Kushtet Standarde kanë kuptimet përkatëse të cilat u janë dhënë atyre atjedhe afatet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

“Përfaqësues i Autorizuar Huamarrësit” do të thotë Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Huamarrësit.

“Kushtet e Përcaktuara të Performancës” do të thotë Kriteret e Performancës 1 deri në 8 dhe 10 (ose siç mund ta kërkojë konteksti, cilido nga këto Kriteria të Performancës) të Kriteve të Performancës të muajit maj 2014 dhe që kanë lidhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të Bankës të muajit maj 2014.

“Plan i Veprimit Social dhe Mjedisor” do të thotë plani për masat lehtësuese sociale dhe mjedisore dha masat përmirësuese me datën e kësaj Marrëveshjeje ose rreth saj, një kopje e të cilit është bashkëlidhur këtu si Skeduli 4, siç mund të jetë ndryshuar ky plan herë pas here me miratimin paraprak me shkrim nga Banka, në përputhje me Seksionin 3.04(e).

“Ligj Mjedisor dhe Social” do të thotë çdo ligj ose rregullore e zbatueshme që lidhet me:

a) ndotjen ose mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë ligjet ose rregulloret përkatëse në lidhje me pjesëmarrjen në vendimmarrje;

b) kushtet e punës dhe të punësimimit;

c) sigurinë shëndetësore dhe profesionale;

d) shëndetin publik, sigurinë dhe sigurimin;

e) popullsinë vendase;

f) trashëgiminë kulturore; ose

g) risistemimin apo zhvendosjen ekonomike të personave.

“Çështje Mjedisore dhe Sociale” do të thotë çdo çështje, e cila është subjekt i çdo Ligji Mjedisor dhe Social, çdo Kriteri të Përcaktuar të



Performancës ose Plani të Veprimit Mjedisor dhe Social.

“Vit Fiskal”do të thotë viti fiskal i Huamarrësit që fillon më 1 janar të çdo viti.

“Ndikim Negativ Material” do të thotë një ndikim negativ material:

a) në gjendjen financiare të Huamarrësit dhe të Filialit/eve të tij; ose

b) në aftësinë e Huamarrësit për të realizuar ose për të qenë në përputhje me çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje.

“Plani i Reformës”do të thotë:

(a) dokumenti me titull “Programi i BERZH-it për Ristrukturimin e KESH-it dhe të Sektorit të Energjisë Elektrike në Shqipëri” të bashkëlidhur si Skeduli 3 dhe përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje, siç mund të ndryshohet ky dokument herë pas here me miratimin e Bankës dhe

(b) nga data në të cilën Huamarrësi dhe Banka miratojnë CGAP-në e referuar në Pjesën D të Skedulit 3, CGAP-ja dhe secila nga detyrat e identifikuar në CGAP si detyrim i Huamarrësit, Garantuesi ose çdo agjenci shtetërore ose autoritet apo cilado nga nën-divizionet e tyre përkatëse ose cilido nga subjektet e zotëruar dhe të kontrolluar prej tyre ose që operojnë për llogari dhe në përfitim të Garantuesit.

### **Seksioni 1.03. Interpretimi**

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një Neni, Seksioni ose Skeduli të specifikuar, me përjashtim kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të interpretohet si referencë e atij Neni ose Seksioni të kësaj Marrëveshjeje.

## **Neni 2**

### **Afatet kryesore të huasë**

#### **Seksioni 2.01. Shuma dhe Monedha**

a) Në bazë të afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë pa kufizim Seksionin 2.01(c), Banka pranon t'i japë hua Huamarrësit me afatet dhe kushtet e parashtruara ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën deri në 218 milion EURO.

b) Huaja do të përbëhet nga dy Këste, si më poshtë:

1) Kësti A në shumën deri në 118 milion EURO; dhe

2) Kësti B në shumën deri në 100 milion EURO.

c) Kësti B nuk është dhënë dhe do të bëhet i disponueshëm vetëm sipas gjykimit të Bankës nëpërmjet njoftimit me shkrim për Huamarrësin pas:

1) plotësimit ose heqjes dorë (qoftë e kushtëzuar ose e pakushtëzuar) e secilës nga detyrat të identifikuar si “Afati i Këstit B” në Planin e Reformës,

2) përfundimit të shqyrtimit të tregut dhe, nëse është e zbatueshme, një zvogëlim të shumës së Këstit B në vijim të procesit të parashtruar në Pjesën J të Planit të Reformës;

3) Banka të ketë marrë një përdorim të rishikuar të fondeve për Këstin B në formularin e Skedulit 1, duke përcaktuar borxhin që do të rifinancohet me shumën e Këstit B;

4) Banka të ketë marrë çdo informacion të mëtejshëm që kërkon dhe të ketë marrë miratimin e komitetit të saj menaxhues dhe të Bordit të Drejtorëve.

#### **Seksioni 2.02. Afate të tjera Financiare të Kredisë**

a) Shuma Minimale e Tërheqjes do të jetë 20 milionë EURO.

b) Shuma Minimale e Parapagimit do të jetë 20 milionë EURO.

c) Shuma Minimale e Anulimit do të jetë 20 milionë EURO.

d) Datat e Pagesave të Interesit do të jenë 10 prill dhe 10 tetor i çdo viti.

e) (1) Huamarrësi do të shlyejë Kredinë në 28 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) më 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti, me Datën e parë të Shlyerjes të Kredisë që do të jetë 10 tetor 2017 dhe me Datën e fundit të Shlyerjes të Kredisë që do të jetë 10 prill 2031.

2) Pavarësisht nga sa më sipër, në rast se: (i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e Kredisë përpara Datës së Parë të Shlyerjes të Kredisë, të specifikuar në Seksionin 2.02.(e), dhe (ii) Banka zgjat Datën e Fundit të Disponueshmërisë, të specifikuar në Seksionin 2.02.(f) më poshtë, pas një date e cila bie pas Datës së Parë të Shlyerjes të Kredisë, shumën e çdo tërheqjeje të bërë në ose pas Datës së Parë të Shlyerjes të Kredisë do të ndahet për t'u shlyer në shumën të barabarta në disa Data të Shlyerjes të Kredisë, të cilat bien pas datës së kësaj tërheqjeje (Banka rregullon shumën e shpërndara



sipas nevojës për të arritur numra të plotë në çdo rast). Banka, herë pas here, do të njoftojë Huamarrësin për këto shpërndarje.

f) Data e Fundit e Disponueshmërisë do të jetë viti i dytë i Datës së Hyrjes në Fuqi ose ndonjë datë tjetër e mëvonshme që Banka mund të vendosë sipas gjykimit të saj dhe të njoftojë Huamarrësin dhe Garantuesin.

g) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës Tarifën e Angazhimit prej 0.5% në vit, mbi totalin e Shumës së Disponueshme për çdo Këst. Tarifa e Angazhimit për Këstin A do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së Marrëveshjes të Kredisë dhe Tarifa e Angazhimit për Këstin B do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës në të cilën Banka konfirmon me shkrim disponueshmërinë e Këstit B dhe do të mblidhet dhe llogaritet në të njëjtën bazë të interesit sipas Seksionit 3.04(b)(ii). Tarifa e Angazhimit do të jetë e pagueshme në çdo Datë të Pagimit të Interesit (megjithëse në atë datë mund të mos ketë asnjë interes për të paguar) duke filluar në Datën e parë të Pagimit të Interesit, pas Datës së Hyrjes në Fuqi.

h) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me një për qind (1%) (ose një shumë tjetër të tillë të specifikuar në Marrëveshjen e Kredisë) të shumës së principalit për çdo Këst. Për Këstin A, ai do të paguhet pas përmbushjes së Kushteve për Hyrjen në Fuqi sipas Afateve dhe Kushteve Standarde; për Këstin B, ai do të paguhet pas përmbushjes së kushteve të vendosura në njoftimin me shkrim për Huamarrësin, i cili është referuar në pikën 2.01(c).

i) Huaja është subjekt i Normës së Ndryshueshme të Interesit, sipas specifikimit në Afatet dhe Kushtet Standarde.

### **Seksioni 2.03. Tërheqjet**

a) Shuma e Disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me dispozitat e Skedulit 2 për të: (1) rfinansuar borxhet afatshkurtra Borxhe të Huamarrësit të përcaktuara në Skedulën 1 dhe (2) Komisionin Fillim-Mbarim.

b) Tërheqjet duhet të paguhet në llogaritë bankare të listuara në Skedulën 1 për llogaritë në EURO. Për llogaritë në monedhat e tjera, shuma për t'u tërhequr në EURO do të miratohet nga Huamarrësi dhe llogaria bankare dhe do t'i njoftohet Bankës.

### **Neni 3**

#### **Zbatimi i Projektit**

#### **Seksioni 3.01. Marrëveshje të tjera të Pranuar të Projektit**

Përveç sipërmarrjeve të përgjithshme të parashtruara në Nenin IV të Afateve dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të aplikojë financimin e dhënë nga Huaja në mënyrë ekskluzive për Projektin;

b) do të ruajë ekzistencën e korporatës së tij në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme;

c) do të realizojë detyrat e nevojshme brenda fuqisë së tij, për të garantuar që secili nga kushtet dhe afatet e vendosura në Planin e Reformës (duke përfshirë pa kufizim, secilin nga kushtet dhe afatet e vendosura në CGAP, sapo të miratohen në mënyrë reciproke nga Banka dhe Huamarrësi) është përmbushur dhe arritur siç kërkohet në datat përkatëse ose afatet përfundimtare të vendosura në to;

d) do të bashkëpunojë me çdo konsulent të angazhuar nga Banka në lidhje me këtë dhe do të mundësojë zbatimin dhe përfundimin e BT-së të Drejtimit të Korporatës, BT-së të Aftësisë Ripërtëritëse Klimaterike dhe zbatimin e CGAP-it në përputhje me Planin e Reformës;

e) do të aplikojë rregullisht tek autoritetet e duhura për rishikimin e tarifës në përputhje me metodologjitë e tarifës, të miratuara dhe të parashtruara në Planin e Reformës;

f) do të drejtojë biznesin e saj me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, sipas praktikave të qëndrueshme inxhinierike, financiare dhe të biznesit, në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi dhe me kujdesin e duhur për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë;

g) do të zbatojë Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social;

h) do të përdorë metoda prokurimi, të cilat sigurojnë një përzgjedhje të mirë të mallrave dhe shërbimeve me vlerën e tregut të lirë dhe që Huamarrësi po kryen investimet e veta kapitale në një mënyrë me efikasitet në kosto dhe në përputhje me ligjin Shqiptar;

i) do të marrë, mbajë, rinovojë dhe do të jetë në përputhje me të gjitha licencat, miratimet dhe regjistrimet e nevojshme;



j) do të bëjë sigurimin, duke përfshirë, kur është e nevojshme, sigurimin e risqeve hidrologjike, në mënyrë të pranueshme dhe me sigures të pranueshëm për Bankën;

k) do të mbajë kontabilitetin, sistemet e kontrollit të kostos dhe të informacionit për menaxhim dhe librat e kontabilitetit në përputhje me IFRS-në. Deri në dhe duke përfshirë vitin financiar 2016, herë pas here do të përdoret IFRS-ja siç është miratuar nga Republika e Shqipërisë. Për vitin financiar 2017 dhe më pas, pasqyrat financiare do të jenë në përputhje të plotë me IFRS-në. Huamarrësi do të bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar që opinioni i auditimit për vitet financiare 2017 dhe më pas do të jetë i pakualifikuar;

l) do të mbajë auditues të pranueshëm për Bankën;

m) do të jetë në përputhje me të gjitha marrëveshjet në të cilat është palë ose detyruese për to apo asetet e tyre;

n) do të paguajë të gjitha taksat në kohën e duhur dhe të bëjë depozitimet në kohë të taksave të duhura dhe të raporteve qeveritare;

o) do të paguajë të gjitha taksat, tarifat ose detyrimet e tjera të pagueshme në lidhje me çdo Marrëveshje Financiare; dhe

p) do të zbatojë çdo dokument tjetër dhe do të ndërmarrë çdo veprim tjetër që Banka e çmon të nevojshëm ose të dëshirueshëm për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Garancisë.

### **Seksioni 3.02. Marrëveshje për Përputhshmërinë Mjedisore dhe Sociale**

Pa kufizuar përgjithësinë e Seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të Afateve dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, Huamarrësi do të bëjë që çdo Kontraktues të realizojë Projektin në përputhje me Kriteret e Përcaktuara të Performancës, me Ligjet Mjedisore dhe Sociale dhe me të gjitha lejet përkatëse mjedisore, liçencat, certifikatat dhe miratimet.

b) Pa kufizuar sa më sipër, Huamarrësi do të zbatojë me kujdes dhe do t'i përmbahet Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social dhe do të monitorojë zbatimin e këtij plani në përputhje me dispozitat e monitorimit që përmban ky plan.

c) Në vitin 2019 dhe çdo tre vjet kalendarikë pas 31 korrikut të atij viti, Huamarrësi do të prokurojë me shpenzimet e tij që: (1) të kryhet një auditim mjedisor, social, shëndetësor dhe i sigurisë së Projektit, nga një ekspert i pavarur i caktuar nga Huamarrësi sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën dhe (2) rezultatet e këtij auditimi t'i dorëzohen Bankës.

d) Huamarrësi dhe Banka, herë pas here mund të bien dakord të ndryshojnë Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social në përgjigje ndaj ndryshimeve në rrethanat e Projektit ose të Huamarrësit, dukurive të paparashikuara dhe rezultateve të monitorimit. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër,

(1) nëse ka ndonjë ndikim negativ mjedisor apo social ose çështje, e cila nuk është parashikuar ose e përfshirë në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, qoftë në tërësi ose në kufizimet e saj,

(2) nëse ndonjë masë lehtësuese e parashtruar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social nuk është e mjaftueshme për të eliminuar ose zvogëluar çfarëdo ndikimi mjedisor dhe social në nivelin e parashikuar nga Kriteret e Përcaktuara të Performancës përkatëse brenda kuadrit kohor të parashtruar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, ose

(3) nëse nga inspektimi i ndonjë autoriteti rregullator ose zbatues ose nga ndonjë auditim i kryer në përputhje me Seksionin 3.04(d), është identifikuar ndonjë papërfshirshmëri materiale me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ose me Ligjin Mjedisor dhe Social

Huamarrësi, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në bazë të miratimit nga Banka, do të zhvillojë dhe përfshijë në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social masa të tilla lehtësuese ose korrigjuese shtesë, siç mund të jetë e nevojshme për të arritur përputhshmërinë me Kriteret e Përcaktuara të Performancës, në çdo rast në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

### **Seksioni 3.03. Konsulentët**

Huamarrësi do të sigurojë pa pagesë për të gjithë konsulentët e angazhuar për të asistuar në çështjet e lidhura me Projektin ose me operacionet e Huamarrësit, të gjitha lehtësirat dhe mbështetjen e nevojshme për realizimin e funksioneve të tyre, duke përfshirë ambiente zyre, pajisje dhe furnizimet e fotokopjimeve,



shërbimet sekretariale dhe transportin, si dhe të gjitha dokumentet, materialet dhe informacionin tjetër që mund të lidhen me punën e tyre.

#### **Seksioni 3.04. Shpeshhtësia e Raportimit dhe Kërkesat për Dorëzimin**

a) Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi derisa shuma e plotë e Kredisë të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës raportet vjetore për Çështjet Mjedisore dhe Sociale që rrjedhin në lidhje me Huamarrësin ose me Projektin, siç referohen në Seksionin 5.02(c) (iii) të Afateve dhe Kushteve Standarde, brenda 60 ditëve pas përfundimit të vitit për të cilin do të raportohet. Këto raporte do të përfshijnë informacion për çështjet e mëposhtme specifike:

1) informacion për përputhshmërinë nga Huamarrësi me Kriteret e Përcaktuara të Performancës, siç përshkruhen në Seksionin 3.02(a) dhe zbatimin e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social;

2) informacion për zbatimin e planit të angazhimit të grupeve të interesit, i duhur sipas Kriterit 10 të Përcaktuar të Performancës, duke përfshirë një përmbledhje të të gjitha ankesave të marra dhe se si janë zgjidhur këto ankesa;

3) informacion për përputhshmërinë nga Huamarrësi me Ligjet Mjedisore dhe Sociale në lidhje me Projektin, duke përfshirë një përshkrim të çdo pretendimi, procedimi, urdhri apo hetimi të filluar ose kërcënues ndaj Huamarrësit, statusin e çdo Autorizimi të kërkuar për Projektin, rezultatet e çdo inspektimi të kryer nga çdo autoritet rregullator, çdo shkelje të ligjeve të zbatueshme, rregulloreve ose standardeve dhe çdo veprim korrigjues ose gjobë në lidhje me këtë shkelje, një përmbledhje të çdo njoftimi material, raporti dhe komunikimi tjetër për Çështjet Mjedisore dhe Sociale në lidhje me Projektin të paraqitur nga Huamarrësi në çdo autoritet rregullator dhe çdo rrethanë tjetër e cila sjell përgjegjësi për Huamarrësin, për çdo Çështje Mjedisore dhe Sociale;

4) informacion për menaxhimin e shëndetit profesional dhe të sigurisë dhe regjistrimin e shëndetit profesional dhe të sigurisë së Projektit, duke përfshirë normat e aksidenteve, incidente që harxhojnë kohë dhe që rrezikojnë humbje, çdo masë parandaluese ose lehtësuese të marrë ose të planifikuar nga Huamarrësi, çdo trajnim të personelit për shëndetin profesional dhe sigurinë

dhe çfarëdo iniciativa të tjera në lidhje me menaxhimin e shëndetit profesional dhe të sigurisë, të cilat janë zbatuar ose planifikuar nga Huamarrësi;

5) një përmbledhje të çdo ndryshimi në Ligjet Mjedisore dhe Sociale të cilat mund të kenë ndikim material në Projekt; dhe

6) kopje të çdo informacioni për Çështjet Mjedisore dhe Sociale të dorëzuar në mënyrë periodike nga Huamarrësi tek aksionarët e tij ose te publiku i gjerë.

b) Në mënyrë të menjëhershme pas ndodhjes së çdo incidenti apo aksidenti në lidhje me Huamarrësin, i cili mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm negativ për mjedisin ose shëndetin apo sigurinë publike ose profesionale, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe menjëherë më pas do t'i japë Bankës njoftimin për to, duke specifikuar natyrën e këtyre incidenteve ose aksidenteve dhe të gjitha hapat që Huamarrësi ka marrë për korrigjimin e tyre. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër,

1) Një incident ose aksident konsiderohet të ketë ndikim negativ të konsiderueshëm në mjedis ose në shëndetin apo sigurinë publike ose profesionale nëse:

A) çdo ligj i zbatueshëm kërkon njoftim të këtij incidenti apo aksidenti tek ndonjë Autoritet Qeveritar,

B) ky incident apo aksident përfshin fatalitetin e ndonjë personi (pavarësisht nëse ky person është i punësuar apo jo nga Huamarrësi),

C) më shumë se një person (pavarësisht nëse këta persona janë të punësuar apo jo nga Huamarrësi) ka marrë dëmtime serioze, të cilat kërkojnë shtrimin në spital ose

D) ky incident apo aksident është bërë ose ka mundësi të bëhet i njohur publikisht qoftë nëpërmjet mbulimit nga media apo në mënyra të tjera.

c) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo protestë të rëndësishme nga punonjësit e anëtarëve të publikut drejtuar ose që ka lidhje me Huamarrësin, e cila mund të ketë ndikim material negativ për Huamarrësin ose që është bërë apo mund të bëhet i njohur publikisht nëpërmjet mbulimit nga media apo në mënyra të tjera. Brenda dhjetë ditëve në vijim të këtij njoftimi, Huamarrësi do të dorëzojë një raport të pranueshëm për Bankën ku të specifikojë



rezultatit e hetimit të Huamarrësit për këtë protestë dhe çdo hap të ndërmarrë ose propozimet që do të bëhen nga Huamarrësi për të zgjidhur çështjet e ngritura në kundërshtim.

#### Neni 4

### Marrëveshjet financiare dhe operacionale

#### Seksioni 4.01. Regjistrat Financiarë dhe Raportimi i Planit të Reformës

a) Huamarrësi do të realizojë procedurat, regjistrat dhe llogaritë në mënyrë të përshtatshme për të pasqyruar, në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara të kontabilitetit të zbatuara në mënyrë të qëndrueshme, operacionet dhe kushtet financiare të Huamarrësit dhe të Degëve të tij, nëse ka dhe do të monitorojë dhe regjistrojë në mënyrë të përshtatshme ecurinë e Projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që do të rrjedhin prej tij).

b) Huamarrësi do të:

1) ketë regjistrat e tij, llogaritë dhe pasqyrat financiare (duke përfshirë bilancin e tij, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrat e ndryshimeve të pozicionit financiar dhe shënimet e tyre) dhe regjistrat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të Degëve të tij, për çdo Vit Financiar, të audituara nga auditues të pavarur të pranueshëm nga Banka në përputhje me parimet dhe standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit;

2) japë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo Viti Financiar:

A) kopje të vërtetuara të pasqyrave të tij financiare për atë Vit Financiar pasi të jenë audituar;

B) raportin e këtij auditimi nga ata auditues të kësaj dhe në ato detaje që Banka mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme; dhe

C) një paraqitje të të gjitha transaksioneve financiare midis Huamarrësit dhe secilës nga Degët dhe Filialet e tij;

dhe

3) të furnizojë Bankën me atë lloj informacioni tjetër në lidhje me ato regjistra, llogari dhe pasqyra financiare dhe me auditimin e tyre, siç mund të kërkojë Banka herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

c) Nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje derisa të shlyhet ose të anulohet e gjithë shuma e Kredisë, Huamarrësi do të dorëzojë në Bankë:

1) çdo tremujor, brenda 60 ditëve pas përfundimit të tij, pasqyrat financiare të paaudituar në IFRS;

2) çdo gjashtëmuajor, brenda 60 ditëve pas përfundimit të tij ose siç mund t'i kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme, një diskutim të menaxhimit për statusin dhe ecurinë e projektuar të secilit nga veprimet e vendosura në Planin e Reformës, duke përfshirë një analizë të Treguesve të Performancës së produktivitetit dhe të efikasitetit të vendosur në Pjesën K të Planit të Reformës;

3) çdo raportim shtesë të specifikuar shprehimisht siç kërkohet të dërgohet në Bankë sipas CGAP-it;

4) një muaj para fundit të çdo viti financiar (në vitin 2016 afati i fundit do të jetë data 15 dhjetor 2016) do të paraqitet në Bankë për shqyrtimin e tij dhe për koment një plan biznesi i përgjithshëm 3 vjeçar, në formën dhe përmbajtjen e pëlqyeshme nga Banka, Plan i cili duhet të përfshijë, por pa u kufizuar tek shpenzimet operative, rezultatet e planifikuara dhe tarifat, të ardhurat nga investimet dhe ndikimin e mundshëm në secilin nga Raportet Financiare të vendosura në Seksionin 4.03. Plani i biznesit do të jetë në përputhje me kriteret e tjera të përshkruara në Planin e Reformës;

5) çdo informacion tjetër që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme, duke përfshirë të drejtën e hyrjes në objektet e Huamarrësit, librat e llogarisë dhe regjistrat e njoftimeve me njoftim të arsyeshëm nga Banka për Huamarrësin; dhe

6) njoftim të menjëhershëm për çdo Praktikë të Ndaluar aktuale ose të dyshuar.

#### Seksioni 4.02. Marrëveshje Negative Financiare

a) Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, nuk do të ndërmarrë asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i japë Bankës të gjithë atë lloj informacioni për to, siç Banka mund ta kërkojë në mënyrë të pranueshme:

1) nuk do të hyjë në asnjë marrëveshje apo masë për të garantuar ose në ndonjë mënyra apo në ndonjë kusht të bëhet detyruese për të gjithën ose një pjesë të ndonjë detyrimi financiar ose tjetër lloj të një personi tjetër, duke përfshirë çdo Degë apo Filial, duke pasur parasysh që



dispozitat e këtij Seksioni 4.02(a)(1) nuk do të zbatohen në qoftë se, pas hyrjes në një marrëveshje ose ujdë të tillë (e cila, për të shmangur dyshimet, do të merret në konsideratë për qëllime të llogaritjes së raportit financiar të vendosur në këtë Marrëveshje), Huamarrësi mbetet në përputhje me angazhimet financiare të vendosura në këtë Marrëveshje;

2) nuk do të hyjë në asnjë transaksion me asnjë person, me përjashtim të kursit të zakonshëm të biznesit, në terma të zakonshëm tregtarë dhe në bazë të marrëveshjeve të përshtatshme me kushtet e tij ose të vendosë çfarëdo blerje të vetme dhe ekskluzive ose agjenci shitjesh ose të hyjë në çfarëdo transaksion me anë të së cilit Huamarrësi mund të paguajë më shumë se çmimi i zakonshëm tregtar për çfarëdo blerje ose mund të marrë më pak se çmimi i plotë tregtar i punimeve “*ex-works*” (subjekt për ulje çmimesh normale tregtare) për produktet ose shërbimet e tij;

3) nuk do të hyjë në asnjë partneritet, ndarje përfitimesh ose marrëveshje privilegjuese apo marrëveshje të tjera të ngjashme, në të cilën të ardhurat ose fitimet e Huamarrësit janë ose mund të jenë të ndara me ndonjë person tjetër i cili mund të ketë një Ndikim Negativ Material;

4) (pavarësisht me dëshirë apo pa dëshirë), nuk do të bëjë asnjë parapagim, riblerje ose shlyerje të çfarëdo borxhi ose të bëjë një shlyerje të çfarëdo borxhi në përputhje me çfarëdo dispozitë ose çfarëdo marrëveshje ose notë e cila ndikon drejtpërdrejt ose tërthorazi në përshpejtimin e shlyerjes në kohë të shumës, përveç në ndonjë rast të tillë, në qoftë se Banka e kërkon ashtu, Huamarrësi në të njëjtën kohë bën një parapagim në përpjesëtim me shumën e principalit të paguar deri atëherë të Kredisë në përputhje me dispozitat e Seksionit 3.07 të Afateve dhe Kushteve Standarde (duke përjashtuar që shuma e çdo parapagimi të tillë nuk do të jetë subjekt i kriterëve të Shumës Minimale të Parapagimit);

5) nuk do të shesë, transferojë, japë me qira ose verë në dispozicion në forma të tjera të gjithën ose një pjesë të rëndësishme të asetëve të saj (qoftë në një transaksion ose në një seri transaksionesh, të lidhura ose të ndryshme) ose

6) nuk do të ndërmarrë ose të lejojë asnjë shkrirje, bashkim ose riorganizim i cili mund të

ketë një Ndikim Negativ Material ose ndryshe nuk do të jetë në përputhje me asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Huamarrësi, pa e informuar Bankën të paktën 30 ditë më përpara, nuk do të ndërmarrë asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i japë Bankës të gjithë atë lloj informacionin për to siç mund ta kërkojë Banka në mënyrë të pranueshme:

1) të lidhë ndonjë kontratë menaxhimi ose marrëveshje të ngjashme me anë të së cilës biznesi i saj ose operacionet janë menaxhuar nga ndonjë person tjetër, duke përfshirë çdo Filial apo Degë; ose

2) të formojë ndonjë Filial ose të bëjë apo të lejojë për kreditë ekzistuese ose përfitime ndaj tyre ose depozitave (me përjashtim të depozitave në kursin e zakonshëm të biznesit me bankat me reputacion) me persona të tjerë ose investime në asnjë person, duke përfshirë çdo Degë apo Filial; megjithatë, duke pasur parasysh që Huamarrësi do të jetë i lirë për të investuar në letra me vlerë të nivelit të investimeve afatshkurtra, vetëm për t'i dhënë punësim të përkohshëm burimeve të papërdorura të Huamarrësit.

3) futet në ndonjë borxh të ri financiar nëse dhe deri në shtrirjen që ai mund të rezultojë në shkelje të Raportit Financiar.

4) deklarojë ose të bëjë ndonjë pagesë të dividendëve përveç (i) Borxhi ndaj EBITDA është i barabartë ose më i vogël se 4, dhe (ii) EBITDA ndaj Interesit është e barabartë ose më e madhe se 4.

#### **Seksioni 4.03. Marrëveshje të tjera Financiare**

Pa kufizuar përgjithësinë e Seksionit 4.02, Huamarrësi do të:

a) Mbajë një Borxh në normën EBITDA prej:

1) 8x në Vitin Financiar 2016;

2) 6x në Vitin Financiar 2017;

3) 5x në Vitin Financiar 2018; dhe

4) 4 x në Vitin Financiar 2019 dhe më pas gjatë gjithë afatit të huasë.

Për qëllimet e llogaritjes, “Borxh” është shuma e borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë (por duke përjashtuar borxhin i cili është trajtuar në përputhje me Skedulën 3 pjesa (B) (i) ose (ii)), dhe “EBITDA” është Fitimi përpara Interesave, Taksave, Zhvlerësimit dhe Amortizimit, në përputhje me IFRS-në.



b) Mbajë një EBITDA në normën e Interesit prej:

1) 3x në Vitin Financiar 2016; dhe

2) 4x në Vitin Financiar 2017 dhe më pas gjatë gjithë afatit të huasë.

Llogaritja e mësipërme do të bëhet në përputhje me IFRS-në, por duke përjashtuar borxhin i cili është trajtuar në përputhje me Skedulën 3 pjesa (B) (i) ose (ii).

#### **Seksioni 4.04. Drejtimi i Biznesit dhe Operacionet**

Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, do të:

a) drejtojë biznesin dhe operacionet e tij në përputhje me praktikën dhe standardet administrative, financiare, inxhinierike më të qëndrueshme të njohura ndërkombëtarisht dhe me praktikën e standarde të tjera përkatëse dhe me vëmendjen e duhur ndaj të gjitha politikave kryesore operuese të tij;

b) ndërmarrë me shpejtësi të gjitha veprimet Brenda fuqive të tij për të mbajtur ekzistencën e tij ligjore, të kryejë për operacionet e tij dhe të blerë, të mbajë dhe të rinovojë të gjitha të drejtat, atributet, fuqitë, privilegjet dhe ekskluzivitetet që janë të nevojshme për drejtimin e bizneseve të tij, duke përfshirë realizimin e Projektit;

c) mos shesë, japë me qira ose disponojë në forma të tjera asnjë nga asetet e tij të cilat nevojiten për kryerjen me efikasitet të operacioneve të tij ose disponim, të cilat mund të dëmtojnë aftësinë e tij për të realizuar në mënyrë të kënaqshme cilindo nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

d) njoftojë menjëherë Bankën për çdo propozim për ndryshim, pezullim apo anulim të cilësdo nga dispozitat e Statutit dhe t'i japë Bankës mundësi të përshtatshme për të komentuar mbi këtë propozim para se të ndërmarrë ndonjë veprim mbi të;

e) Pajiset dhe mbajë me sigures të përgjegjshëm ose të hartojë dispozita të tjera të pranueshme për Bankën në lidhje me: sigurimin, duke përfshirë, kur është e nevojshme, sigurimin ndaj riskut hidrologjik, ndaj risqeve të tilla si humbja, dëmtimi dhe përgjegjësia dhe në shumën të tilla që janë të pajtueshme me praktikën e duhur; dhe

f) Operojë dhe mirëmbajë gjatë gjithë kohës impiantet e tij, shërbimet, pajisjet dhe pronat e

tjera në gjendje të mirë pune dhe menjëherë sapo të nevojitet, të bëjë të gjitha riparimet dhe rinovimet e nevojshme të tyre, të gjitha në përputhje me bizneset dhe me praktikën e mirë financiare

Neni 5

#### **Pezullimi; përsheptimi; anulimi**

##### **Seksioni 5.01. Pezullimi**

Sa më poshtë vijon janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 7.01(a)(xvii) të Afateve dhe Kushteve Standarde:

a) Kuadri ligjor dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin energjetik në territorin e Garantuesit do të jetë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose nuk do të merret parasysh në një mënyrë që mund të ketë Ndikim Negativ Material, ndryshe nga sa është miratuar me shkrim nga Banka;

b) Statutet do të jenë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose nuk do të merren parasysh;

c) Huamarrësi do të ketë ndërmarrë cilindo nga veprimet e referuara në Seksionin 4.02(b) në mënyrë që të ndikojë materialisht dhe në të kundërt operacionet ose ushtin financiar të Huamarrësit ose mundësinë e tij për të kryer Projektin ose të realizuar cilindo nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

d) Kontrolli i Huamarrësit do të jetë transferuar tek një palë e ndryshme nga Garantuesi.

Neni 6

#### **Hyrja në fuqi**

##### **Seksioni 6.01. Kushtet Para Hyrjes në Fuqi**

Sa më poshtë janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 9.02(c) të Afateve dhe Kushteve Standarde si kushte shtesë për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Garancisë:

a) Secila nga detyrat e vendosura në Planin e Reformës si një zë për tu realizuar si “CP për Efektivitetin” do të jenë përfunduar në një përmbajtje të pëlqyeshme për Bankën;

b) Banka ka marrë një listë të projekteve të investimeve për modernizimin dhe përmirësimet që rezultojnë në rritje të mbrojtjes mjedisore dhe/ose përmirësimet e efikasitetit të energjisë për një shumë të përgjithshme të barabartë me të





paktën 10 milion EURO e cila do të zbatohet nga Huamarrësi brenda 5 vjetëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

### Seksioni 6.02. Opinione Ligjore

a) Për qëllimet e Seksionit 9.03(a) të Afateve dhe Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshillit do të jepen në emër të Huamarrësit nga Drejtori i Çështjeve Ligjore të Huamarrësit.

b) Për qëllimet e Seksionit 9.03(b) të Afateve dhe Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshillit do të jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

### Seksioni 6.03. Përfundimi për Moshyrjen në Fuqi

Data një vit pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllime të Seksionit 9.04 të Afateve dhe Kushteve Standarde.

Neni 7  
Të ndryshme

### Seksioni 7.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 10.01 të Afateve dhe Kushteve Standarde:

Për Huamarrësin:

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

Blloku “Vasil Shanto”

Tirana

Albania (Shqipëri)

Në vëmendje të: Drejtorit të

Përgjithshëm Ekzekutiv

Faks: +355 422 32046

Për Bankën:  
BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

One Exchange Square

London (Londër) EC2A 2JN

United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operacioneve

Faks: +44-20-7338-6100

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë lidhur këtë Marrëveshje të nënshkruar në katër kopje dhe të dërguar në Tiranë, Shqipëri në ditën dhe në vitin e shkruar në fillim më sipër.

### KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

Nga: \_\_\_\_\_

Emri:

Titulli:

### BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: \_\_\_\_\_

Emri:

Titulli:

### SKEDULI 1 - PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

1. Qëllimi i Projektit është të ndihmojë Huamarrësin për të rfinansuar borxhin e mëposhtëm afatshkurtër dhe zbatimin e objektivave të reformës të parashtruara në Planin e Reformës.

**Për Këstin A: deri në 118 milionë EURO nga sa më poshtë:**

| Numri i Llogarisë (IBAN)           | Kreditori              | Monedha | Shuma         | Maturimi i Ardhshëm |
|------------------------------------|------------------------|---------|---------------|---------------------|
| AL37 2081 1008 0000 0200 7293 5320 | Banka Intesa San Paolo | LEK     | 4,200,000,000 | 31 mars 2017        |
| AL95 2081 1008 0000 0200 7293 5343 | Banka Intesa San Paolo | LEK     | 1,000,000,000 | 31 mars 2017        |
| AL78 2021 1013 0000 0000 2200 7057 | Banka Raiffeisen       | LEK     | 4,980,000,000 | 30 shtator 2016     |
| AL66 2021 1013 0000 0000 3000 7057 | Banka Raiffeisen       | LEK     | 1,390,000,000 | 30 shtator 2016     |
| AL81 2021 1013 0000 0000 2000 7057 | Banka Raiffeisen       | EURO    | 16,000,000    | 30 shtator 2016     |
| AL42 2021 1013 0000 0080 0000 7057 | Banka Raiffeisen       | EURO    | 8,000,000     | 30 shtator 2016     |
| AL27 2021 1013 0000 0080 1000 7057 | Banka Raiffeisen       | EURO    | 9,000,000     | 30 shtator 2016     |
| AL28 2021 1013 0000 0000 2300 7057 | Banka Raiffeisen       | LEK     | 5,610,000,000 | 30 shtator 2016     |
| AL33 2021 1013 0000 0004 4000 7057 | Banka Raiffeisen       | LEK     | 4,900,000,000 | 30 shtator 2016     |



|                                    |                          |      |               |                 |
|------------------------------------|--------------------------|------|---------------|-----------------|
| AL70 2051 1021 2003 83CL CUCL ALLA | Banka Kombëtare Tregtare | LEK  | 1,500,000,000 | 23 dhjetor 2016 |
| AL70 2051 1021 2003 83CL CUCL ALLA | Banka Kombëtare Tregtare | LEK  | 1,600,000,000 | 23 dhjetor 2016 |
| AL69 2131 1044 0000 0000 0120 2407 | Societe Generale         | EURO | 6,000,000     | 28 shkurt 2017  |

**Kësti B: një listë e përditësuar e borxheve afatshkurtra do të miratohet me Bankën në kohën që Huamarrësi do të aplikojë për Këstin B.**

#### SKEDULI 2 - KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëlidhur kësaj Skeduli parashtron Kategoritë, shumën e Kredisë të shpërndarë sipas çdo Kategorie dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për çdo Kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë Tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me shpenzimet e bëra përpara datës së Marrëveshjes të Kredisë.

#### Materiali Bashkëlidhur Skedulit 2

| Kategoria  | Shuma e Kredisë së Dhënë në Monedhën e Kredisë | Përqindja e Shpenzimeve që do të Financohen |
|--|--|---|
| (1) Rifinancimi i kredive të përshkruara në Skedulim 1 nga Kësti A | 116,820,000 EURO                               | 100%  |
| (2) Rifinancimi i kredive të përshkruara në Skedulim 1 nga Kësti B | 99,000,000* EURO                               | [100]%                                      |
| (3) Komisioni Fillim-Mbarim i Këstit A                             | 1,180,000 EURO                                 | 100%  |
| (4) Komisioni Fillim-Mbarim i Këstit B                             | 1,000,000** EURO                               | 100%  |
| <b>Totali</b>  | <b>218,000,000 EURO</b>                        |   |

\* Shuma mund të përshtatet duke bërë zbritje në vijim të procesit të referuar në pikën 2.01(c)(2).

\*\* Kjo shumë do të përshtatet në mënyrë të përpjesëtueshme me rregullimet e shumës së kështit B në mënyrë që të jetë 1% e shumës përfundimtare të Këstit B.

#### SKEDULI 3 - PROGRAMI I BERZH-IT PËR KESH-in DHE RISTRUKTURIMI I SEKTORIT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Secili nga Huamarrësit (“KESH-i”) dhe Garantuesi (dhe/ose çdo agjenci apo autoritet përkatës shtetëror ose cilado nga nën-divizionet e tyre përkatëse apo çdo subjekt i zotëruar dhe i kontrolluar prej tyre ose që operon për llogarinë dhe përfitimin e Garantuesit) angazhohet dhe merr përsipër të kryejë dhe të bëjë kryerjen e secilës nga detyrat e mëposhtme sipas datës përkatëse të dhënë. Pamundësia për të realizuar një detyrë sipas programit kohor/datës përkatëse do të jetë shkelje e Seksionit 7.01(a)(iii) të Afateve dhe Kushteve Standarde:

| DETYRA  | PROGRAMI KOHOR/DATAT  |
|---|---|
| <p><b>(A) Kuadri Ligjor</b></p> <p>Garantuesi do të:</p> <p>1. Miratojë Rregullat e Tregut në lidhje me prodhimin dhe aktivitetet e shitjes me shumicë dhe Rregullat e tjera të Tregut me ndikim në KESH, në përputhje me Nenin 19 dhe 98, Ligji për Sektorin Energjetik (PSL), duke përfshirë Rregullat që nxisin Hapjen/ Konkurrencën e Tregut në përputhje me nenin 8(1) PSL, duke u bazuar në nenin 97 PSL.</p> <p>2. Rishikojë çmimet e rregulluara për prodhimin e energjisë elektrike dhe çmimet e tregut të shitjes me shumicë në linjë me përfundimin e kontratës afatgjatë për furnizimin/blerjen e OSHEE/KESH-it, me të ardhura në nivelet e tarifës për KESH-in të konfirmuara me shkrim në mënyrë të pëlqyeshme për EBRD-në.</p> | <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> |



|   |   |
|---|---|
| <p>3. Publikojë të gjitha të dhënat përkatëse të prodhimit në përputhje me Rregulloren e Komisionit të BE-së nr. 543/2013 të datës 14 qershor 2013.</p> <p>4.</p> <p>5. Veprimet në Përputhje me Direktivën 2009/73/EC dhe rregulloren (KE) 715/2009.</p> <p>6. Sigurojë që OSHEE të ndajë shpërndarjen nga furnizimi, për të siguruar përputhjen me Nenet 26 dhe 31 të Direktivës 2009/72/KE dhe Nenit 35 të PSL.</p> <p>7. Heqë rregullimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e tensionit të mesëm.</p>  | <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> <p>Afati i Këstit B</p> <p>Deri në fund të vitit 2017</p> <p>Deri në fund të vitit 2017</p>                  |
| <p><b>(B) Ristrukturimi i Bilancit të KESH-it</b></p> <p><b>Ristrukturimi dhe Heqja e Borxheve që nuk janë të KESH-it:</b> Të gjitha borxhet në bilancin e KESH-it, të cilat nuk kanë lidhje me KESH-in (por, p.sh. janë për OSHEE-në ose për OST-në apo për ndonjë subjekt tjetër të tillë, i cili nuk është degë ose filial i KESH-it): (i) do të hiqen nga KESH-i dhe KESH-i nuk do të jetë më detyrues në lidhje me këto borxhe ose (ii) do të jetë subjekt i një rregullimi të pëlqyeshëm për Bankën ndërkohë që KESH-i mbetet detyruesi ligjor por është plotësisht i dëmshpërblyer në lidhje me të gjitha principalet, interesat, tarifën, kostot dhe shpenzime të tjera që krijohen në lidhje me to dhe rrjedhimisht nuk do të bëjë pagesa për shërbimet e borxheve nga fluksi i tij monetar në asnjë rrethanë (p.sh. shërbimet e borxhit do të jenë nga rregullimet me OSHEE-në dhe OST-në me mbështetje tjetër sipas nevojës).</p> <p>Arkëtimet me vonesë nga subjektet shtetërore dhe arkëtimet e tjera financiare me vonesë do të shprehen në para ose do të fshihen me pagesat e KESH-it ndaj Subjekteve Shtetërore ose Qeverisë së Shqipërisë</p> | <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> <p>Afati i Këstit B</p>  |
| <p><b>(C) Metodologjia e Tarifimit</b></p> <p>Ajencia Rregullatore e Energjisë (ERE) do të realizojë një rishikim gjithëpërfshirës të strukturës së tarifave për subjektet e sektorit, për t'i lidhur me strukturën e re të tregut dhe të përmbajë parimet për vendosjen e çmimeve jo diskriminuese dhe që pasqyrojnë koston.</p> <p>ERE-ja do të përgatitë një metodologji duke përfshirë një metodologji shumëvjeçare për tarifën e rrjetit dhe do t'i japë një kopje Bankës.</p> <p>Rregullorja e re shumëvjeçare për tarifën do të miratohet dhe zbatohet nga ERE.</p>  | <p>Tremujori 4 i vitit 2016 dhe në vazhdim më pas sipas metodologjisë së miratuar</p> <p>Tremujori 2 i vitit 2017</p> <p>Afati i Këstit B</p> |



|  |   |
|--|---|
| <p><b>(D) Drejtimi i Korporatës dhe Struktura e Korporatës</b></p> <p>Plani i Veprimit për Drejtimin e Korporatës (“CGAP”) do të miratohet ndërmjet BERZH-it, KESH-it dhe Garantuesit.</p> <p>KESH-i dhe Garantuesi do të zbatojnë të gjitha detyrat e përcaktuara në CGAP sipas afateve kohore të përcaktuara në GCAP (ose në një datë tjetër të mëvonshme sipas miratimit të BERZH-it).</p> <p>KESH-i do të ndajë më BERZH-in dhe me Konsulentët e BERZH-it të gjithë informacionin e kërkuar për Drejtimin e Korporatës me Kujdesin e Duhur, duke përfshirë por pa u kufizuar tek aktet nënligjore, politikat e brendshme dhe procedurat, dokumentet/raportet përkatëse të kaluara që komentojnë çështjet e drejtimit të korporatës dhe çdo dokument tjetër i cili mund të jetë i dobishëm për drejtimin e korporatës me kujdesin e duhur (“Raportet”).</p> <p>Konsulentët e BERZH-it do të shqyrtojnë Raportet për të identifikuar boshllëqet me praktikat më të mira të Drejtimit të Korporatës. Konsulentët e BERZH-it do të kryejnë gjithashtu një shqyrtim të drejtimit të korporatës dhe do të bëjnë rekomandimet që Garantuesi dhe KESH-i mund të përdorin për të vendosur ose përmirësuar politikat në të gjitha fushat e nevojshme, veçanërisht për kompensimin, rekrutimin, emërimet, planifikimin dhe prokurimet; konsulentët do të përgatisin rekomandimet e detajuara me rishikimin e matricave me kolegët përkatës.</p> <p>Finalizimi i drejtimit të korporatës dhe plani i ristrukturimit do të diskutohen dhe miratohen ndërmjet Garantuesit, KESH-it dhe BERZH-it, me zbatimin e etapave për çdo pikësynim.</p> <p>Finalizimi i zbatimit të drejtimit të miratuar të korporatës, plani i ristrukturimit dhe reforma ligjore.</p> <p>Dorëzohet tek BERZH-i për miratim një plan masash, që do ta sjellin në një investitor të pakicave, në formën dhe përmbajtjen e pranueshme nga BERZH-i.</p> | <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> <p>Gjatë gjithë kohës.</p> <p>Gjatë gjithë kohës.</p> <p>Gjatë gjithë kohës.</p> <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> <p>Tremujori 4 i vitit 2017 dhe Afati i Këstit B</p> <p>Afati i Këstit B</p> |
| <p><b>(E) Tregtia/Tregu Rajonal:</b></p> <p>Garantuesi dhe KESH-i, sipas rastit, do të:</p> <p>krijojnë një treg kombëtar të energjisë të organizuar dhe shkëmbim lokal të energjisë</p> <p>krijojnë një treg kombëtar të energjisë të organizuar dhe shkëmbim lokal të energjisë</p> <p>rishikojë kodet e energjisë elektrike, standardet dhe dokumentacionin përkatës për të lejuar funksionimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike.</p> <p>lejojnë plotësisht tregtinë me instrumentet financiare duke përfshirë të ardhmen dhe opsionet, si dhe të lejojnë kontratat e</p>  | <p>Tremujori 1 i vitit 2018</p> <p>Tremujori 1 i vitit 2018</p> <p>Afati i Këstit B</p> <p>Tremujori 1 i vitit 2018</p> <p>Afati i Këstit B</p>   |



|  |   |
|--|---|
| <p>mbrojtjes dhe të shkëmbimit të energjisë elektrike në treg.</p> <p>Përgatitja e udhëzuesit për lidhjen e tregut shqiptar me tregun e Kosovës dhe mundësia e integritit të mëtejshëm me tregjet rajonale në planin afatmesëm.</p>  |   |
| <p><b>(F) Struktura e Korporatës së Huamarrësit</b></p> <p>Hiqet nga KESH-i detyrimi ligjor dhe operacional për të vepruar si Furnizues me Shumicë i Publikut ose për të blerë nga importi në emër të tregut shqiptar të energjisë.</p> <p>Hiqet nga KESH-i detyrimi ligjor dhe operacional për të qenë pala blerëse në Kontratat PPA të prodhuesve privatë të energjisë (d.m.th. PPA-të do të rinovohen ose në të kundërt do të transferohen ligjërisht jashtë KESH-it).</p>  | <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p>   |
| <p><b>(G) Prodhimi i Huamarrësit</b></p> <p>Garantuesi dhe KESH-i do të përgatiten dhe do të përshtatin strategjinë dhe udhëzuesin për TPP Vlorë, që të vendoset në funksionim në Tremujorin e parë të vitit 2018.</p>   | <p>Afati i Këstit B</p>   |
| <p><b>(H) Aftësia Ripërtëritëse Klimaterike</b></p> <p>Huamarrësi dhe Banka të bien dakord për Termat e Referencës për konsulentët, të cilët do të ndihmojnë Huamarrësin dhe Garantuesin që të ndërtojnë kapacitetin për menaxhimin e riskut klimaterik, duke përfshirë sigurimin hidrologjik (“Konsulenti i Aftësisë Ripërtëritëse Klimaterike”).</p> <p>Tenderimi për Konsulentin e Aftësisë Ripërtëritëse Klimaterike është përfunduar.</p> <p>Plani i zbatjes së Riskut Klimaterik është miratuar nga Garantuesi, Huamarrësi dhe është zbatuar.</p>  | <p>CP deri në Hyrjen në Fuqi</p> <p>Tremujori 4 i vitit 2016</p> <p>Tremujori 4 i vitit 2017</p>                                |
| <p><b>(I) Rrjeti i Sigurisë Sociale</b></p> <p>Garantuesi do të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) përcaktojë konsumatorët në nevojë, në përputhje me kërkesat sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë;</li> <li>2) kryejë analiza për identifikimin e mundësive të përmirësimit të masave të mbrojtjes sociale për të garantuar mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë ndaj rritjes së tarifave, duke përfshirë një analizë të ndikimit të tërthortë;</li> <li>3) rishikojë mekanizma alternativë për zbatimin e programeve të asistencës sociale dhe të rekomandimeve; dhe</li> <li>4) përgatisë rekomandime të qarta të bazuara në analizat e forcimit të sistemit të mbrojtjes sociale</li> <li>5) përshtatë rekomandimet e analizës së mbrojtjes sociale.</li> </ol> | <p>Tremujori 2 i vitit 2017</p> <p>Tremujori 2 i vitit 2017</p> <p>Tremujori 2 i vitit 2017</p> <p>Tremujori 2 i vitit 2017</p> |



|  |             |                         |             |             |  |                  |
|--|-------------|-------------------------|-------------|-------------|--|------------------|
|  |             |                         |             |             |  | Afati i Këstit B |
| <b>(J) Bashkëfinancimi i Këstit B</b>  |             |                         |             |             |  | Afati i Këstit B |
| <p>Garantuesi do të realizojë një rishikim të tregut për të rishikuar dëshirën për të kredituar KESH-in. Pas një periudhe të pranueshme kohore të lejuar për rezultate të qarta nga reformat dhe ristrukturimi i parashikuar sipas Projektit, Garantuesi, KESH-i dhe BERZH-i do të formojnë një grup pune për të rishikuar dëshirën e tregut për të kredituar KESH-in. Nëse ekziston dëshira për t'i dhënë kredi KESH-it për kohëzgjatje prej 5 vjetësh ose më shumë, Banka do të zvogëlojë shumën e Këstit të saj B nëpërmjet shumës së përgjithshme të dhënë nga bankat tregtare ose nga institucionet e tjera financiare.</p> |             |                         |             |             |  |                  |
| <b>(K) Treguesit e Performancës së KESH-it:</b>  |             |                         |             |             |  |                  |
| <b>Arkëtimet nga:</b>  | <b>2016</b> | <b>Afati i Këstit B</b> | <b>2018</b> | <b>2019</b> | <b>2020 e më pas</b>   |                  |
| OSHEE  | 95%         | 100%                    | 100%        | 100%        | 105% derisa të jenë likuiduar të gjitha borxhet e prapambetura |                  |
| Konsumatorët e tjerë   | 100%        | 100%                    | 100%        | 100%        | 100%   |                  |



**SKEDULI 4 - PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL**



**LIGJ**  
**Nr. 129/2016**

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8438,**  
**DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË**  
**ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në nenin 21, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Përveç sa parashikohet në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, në rastet e kredive, të huamarrjes ose financimeve nga personat e lidhur, nuk njihen si shpenzime të zbritshme të periudhës tatimore teprica e shpenzimit të interesit neto që tejkalon 30 për qind të fitimit të tatueshëm para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA). Fitimi i tatueshëm para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit përcaktohet në përputhje me nenin 19 të këtij ligji.

Me termin “Tepricë të shpenzimit të interesit neto” nënkuptohet teprica që del nga diferenca e shpenzimeve të interesit me të ardhurat nga interesi.

Çdo shpenzim interesi, që nuk zbritet sipas kësaj pike, mbartet në periudhat e ardhshme tatimore, përveç nëse 50 për qind të aksioneve ose të të drejtave të votës në shoqëri janë transferuar.

Përcaktimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për bankat, institucionet financiare jobankare të kredidhënies, shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut.

Rregullat për zbatimin e këtij paragrafi përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

**Neni 2**

Në fund të nenit 25, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Shpenzimet e bankave për kontributet vjetore dhe të jashtëzakonshme, në përputhje me ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikës së Shqipërisë”, janë shpenzime të njohura në përcaktimin e fitimit të tatueshëm.”.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç nenit 1, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Miratuar në datën 15.12.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9932, datë 30.12.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**



|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë